




NGA VETJA
PËR SHOQËRINË



2025

BULETINI

VJETOR



Botues: Forumi Rinor Islam
Përgatiti: Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Fotografite: Arkivi i Forumit Rinor Islam
Dizajni: Zejnep Ramadani

Janar, 2026

Përmbajtja - Buletini 2025

Rreth Forumit Rinor Islam	04
Fjalimi i Kryetarit	08
Ligjërata fetare	09
Fushata	12
Bursa për nxënës dhe studentë	16
Platforma “Mozaiku Rinor”	22
Manifestimi “Në gjurmët e më të mirëve”	26
"Ramazani, Çelësi i Fitoreve"	30
25-vjetori i Forumit Rinor Islam	36
Aktivitetet e brendshme	40
Shëtitje	42
Vizita	44
Media	47

Shtrirja e Forumit Rinor Islam

Kumanovë

Rr. Karl Marks nr.60
1300, Kumanovë

Shkup

Rr. Çairska nr.1
1000, Shkup

Tetovë

Rr. Jane Sandanski nr.64
1220, Tetovë



Gostivar

Rr. Sedek Kostoski nr.19
1000, Shkup

Kërçovë

Qendra Tregtare H/R
Arabella
1300, Kërçovë

Prilep

Fsh. Cërnilishtë
7516, Prilep



VIZIONI

Forumit Rinor Islam të jetë udhëheqës në fushën e veprimtarisë rinore shembull i organizatës së suksesshme në zhvillimin shpirtëror, material, kulturor dhe moral të shoqërisë. Një organizatë e afirmuar vendore dhe ndërkombëtare, e cila ecën me proceset integruese.



MISIONI

Promovimi dhe kultivimi i vlerave universale Islame dhe njerëzore, mbrojtja e të rinjëve nga devijimet si dhe ngritja dhe aftësimi i tyre.

POLITIKAT TONA:

- Fokusimi në çështjet prioritare
- Maturia dhe gradualiteti në veprim
- Disiplina në realizimin e detyrave
- Dialogu dhe partneriteti
- Mbrojtja e identitetit kulturor
- Fuqizimi i të rinjëve


QËLLIMET STRATEGJIKE:

- Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm edukativ;
- Rritja e kapaciteteve të anëtarëve , komunikimit, dhe formimit të lidërsipit të qëndrueshëm;
- Zhvillimi i projekteve inovative për ndikim të gjërë;
- Ndërtimi i stabilitetit financiar dhe partneriteteve strategjike

VLERAT TONA:

- Besimi
- Përpikshmëria
- Mesataria
- Vetëmohimi
- Objektiviteti
- Uniteti
- Toleranca
- Mirëkuptimi
- Bashkëpunimi
- Puna institucionale

Struktura Organizative



Kryesia Qendrore



Abdulhamid Mustafa
Kryetar



Erduan Kurtishi
Nënkryetar
Përgjegjës i Zyrës për Projekte dhe Financa



Amar Murtezi
Sekretar i Përgjithshëm
Përgjegjës i Departamentit të Edukimit



Memedali Limani
Kryetar FRI - Kumanovë



Afrim Demiri
Kryetar i FRI - Shkup
Përgjegjës i Departamentit të Fushatave



Arsim Iseni
Kryetar i FRI - Tetovë



Zurijet Sulejmani
Kryetar i FRI - Gostivar



Shukri Sadiku
Kryetar i FRI - Kërçovë



Veton Ibrahim
Kryetar i FRI - Prilep



Vullnet Selmani
Përgjegjës,
Departamenti për
Zhvillim të Brendshëm



Ermira Idrizi
Përgjegjëse, Departamenti
për të Rinj



Zejnep Ramadani
Përgjegjëse, Zyra
për Media



Medin Bajrami
Anëtar




Asri Nuhiju
Anëtar



Behar Tefiku
Bashkëpunëtor

Fjalimi i Kryetarit



Abdulhamid Mustafa
Kryetar

Viti 2025 përfaqëson një fazë të rëndësishme zhvillimi dhe pozicionimi strategjik për Forumin Rinor Islam. Aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti dëshmojnë qartë orientimin e organizatës drejt ndërtimit të një platforme të qëndrueshme edukative dhe rinore, e cila synon formimin e brezave të rinj me identitet të qartë, dije të qëndrueshme dhe përgjegjësi shoqërore.

Forumi Rinor Islam ka vijuar të forcojë rolin e tij si një aktor serioz dhe i besueshëm në hapësirën rinore dhe edukative, duke zhvilluar programe që adresojnë nevojat reale të të rinjve në kontekstin bashkëkohor. Qasja jonë është e ndërtuar mbi vizion afatgjatë, planifikim të qëndrueshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë.

Gjatë këtij viti, është vënë theks i veçantë në konsolidimin institucional, fuqizimin e strukturave organizative dhe koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe degëve lokale. Këto procese kanë krijuar bazë të fortë për rritje të mëtejshme, për standardizim të punës dhe për rritjen e efikasitetit në realizimin e programeve.

Një dimension strategjik i veçantë i vitit 2025 ishte thellimi i bashkëpunimit me institucione dhe partnerë relevantë, në funksion të ndërtimit të projekteve të përbashkëta që kontribuojnë në edukimin, zhvillimin personal dhe aktivizimin konstruktiv të rinisë. Ky bashkëpunim reflekton qartë orientimin e FRI-së drejt një veprimi institucional, të koordinuar dhe të qëndrueshëm.

Po ashtu, zhvillimet e rëndësishme organizative, përfshirë mbajtjen e Kuvendit të XVIII dhe shënimin e 25-vjetorit të themelimit, përfaqësojnë jo vetëm vazhdimësinë institucionale, por edhe një pikë reflektimi dhe ripërcaktimi strategjik për dekadën e ardhshme të veprimtarisë së Forumit Rinor Islam.

Një rol të veçantë në realizimin e këtij vizioni kanë pasur donatorët dhe aktivistët e Forumit Rinor Islam. Mbështetja e donatorëve tanë ka qenë një faktor thelbësor në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të programeve, ndërsa përkushtimi, përgjegjësia dhe angazhimi i aktivistëve në të gjitha nivelet organizative përbëjnë kapitalin më të çmuar të FRI-së dhe garancinë për vazhdimësinë e misionit tonë.

Duke parë përpara, vizioni ynë mbetet i qartë: ndërtimi i një organizate moderne, profesionale dhe të qëndrueshme, e cila investon në formimin intelektual, shpirtëror dhe shoqëror të të rinjve dhe që kontribuon aktivisht në zhvillimin e një shoqërie të përgjegjshme dhe me vlera.

Ky buletin përfaqëson një pasqyrë të punës së realizuar, por mbi të gjitha, një orientim të qartë drejt së ardhmes dhe objektivave strategjike që Forumi Rinor Islam synon t'i realizojë në vitet në vijim.

Abdulhamid Mustafa
Kryetar, Forumi Rinor Islam

A photograph of a man with a beard and short hair, wearing a light-colored shirt, speaking into a microphone. He is standing at the front of a room, facing a group of people whose backs are to the camera. The room has large windows with horizontal blinds in the background. The entire image is overlaid with a semi-transparent green filter.

LIGJËRATA FETARE

Ligjërata fetare

Forumi Rinor Islam prej fillimeve të tij ka qenë një hapësirë ku rinia takohet me dijen dhe vlerat islame. Një ndër shtyllat kryesore të veprimtarisë së FRI-së janë ligjëratat fetare, të cilat synojnë forcimin e dijes dhe ndërgjegjësimin rreth parimeve islame. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë zhvilluar një sërë ligjëratah me tema të ndryshme e me pjesëmarrje të teologëve të njohur.

Ndër këto ligjërata mund të përmendim:



“Ramazani, një udhëtim shpirtëror” - me studiuesin dhe dietarin Ramazan Kayan nga Turqia

“Shkallët drejt kënaqësisë së Zotit” - me hoxhë Halil Avdulli nga Kosova

Nërsa në kuadër të ciklit “Në gjurmët e të dërguarve”, hoxhë Hasan Baftijari ka ligjëruar mbi figura të njohura profetike, duke ofruar reflektime mbi jetën dhe mësimet e tyre.

Deri më tani janë zhvilluar këto ligjërata:



“Ngritja pas gabimit – Ademi a.s”. Ligjërata theksoi se pendimi i sigurtë ishte hapi i parë drejt një fillimi të ri dhe se njeriu nuk duhej të dorëzohej pas gabimit.

“Dritë e dijes – Idrisi a.s”. U theksua se dituria dhe urtësia ishin dritë që udhëhiqnin njeriun drejt së mirës dhe e bënin jetën më të vlefshme.

“Nuhu a.s. – Shembull i qëndrueshmërisë”. Ligjërata tregoi se durimi dhe përkushtimi i palëkundur ishin çelësi për të përballuar sfidat dhe kundërshtimet.





“Hud a.s. – Besimi përballë kokëfortësisë”. U shpjegua se besimi i fortë dhe i sigurtë qëndronte mbi çdo kundërshtim dhe kokëfortësi.

“Thirrje e sigurtë – Salihu a.s.”. Ligjërata nënvizoi se thirrja e pastër dhe e sigurtë drejt së vërtetës ishte mënyra më e mirë për të udhëhequr njerëzit.

“Forca e një zemre të pastër – Ibrahim i a.s.”. U theksua se besimi i fuqishëm buronte nga një zemër e pastër dhe lidhja me Zotin ishte forca më e madhe.



“Largimi nga e keqja – Luti a.s.”. Ligjërata tregoi se shpëtimi dhe paqja arriheshin vetëm kur njeriu largohet nga e keqja dhe zgjidhte rrugën e drejtë.

“Dorëzim i plotë – Ismaili a.s.”. U përmend bindja e plotë ndaj vullnetit të Zotit si shembull i dorëzimit dhe besimit të pakushtëzuar.

“Besim i palëkundur – Is’haku a.s.”. Ligjërata theksoi se besimi i vërtetë nuk lëkundet nga sprovat dhe mbetet i qëndrueshëm.

“Dy zemra të qëndrueshme – Jakubi a.s. dhe Jusufi a.s.”.

U nënvizua se durimi dhe besimi i fortë e mbanin njeriun të qëndrueshëm edhe në sprovat më të vështira.



“Simbol i durimit – Ejubi a.s.”.

Ligjërata tregoi se durimi i jashtëzakonshëm përballë sprovave sillte shpërblim dhe mëshirë hyjnore.

“Modeli i pushtetit të drejtë – Davudi a.s. dhe Sulejmani a.s.”. U theksua se pushteti duhet përdorur për drejtësi dhe mirësi, duke u bazuar në mençuri dhe udhëheqje të drejtë.





FUSHATA

"The woman who gives birth"
preserves her dignity and
pursues her soul
"Her gaze reflects a world
we have inherited, a world
perhaps America never"



Fushata

Me qëllim të promovimit të vlerave islame dhe humane, FRI në vazhdimësi zhvillon fushata të ndryshme në raste të ndryshme. Fushatat më të rëndësishme të zhvilluara gjatë këtij viti janë:

FRI Kumanovë shënoi Ditën Botërore të Mbulesës

Forumi Rinor Islam – dega Kumanovë organizoi aktivitetin “Provo shaminë për një ditë” në qendër të qytetit, ku shumë qytetarë morën pjesë dhe përkrahën nismën. Aktiviteti u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin dhe promovimin e vlerave të modestisë e identitetit të vajzës myslimane.



FRI Tetovë dekoroi semimaturantët më të mirë

Nën moton “Të nxisim dijen, të investojmë për ardhmërinë”, Forumi Rinor Islam – Dega Tetovë organizoi manifestimin e shpalljes së semimaturantëve më të mirë të Tetovës dhe rrethinës. Në amfiteatrin e Fakultetit të Arteve, u dekoruan 25 nxënës të shkollave fillore, ndërsa pjesëmarrësve iu shpërndanë lëvdata, një shumë modeste të hollash dhe libra nga “Furkan ISM”. Fjalën përshëndetëse e mbajti kryetari Arsim Izeni, duke theksuar rëndësinë e përkrahjes së dijes dhe investimit për të ardhmen.





Takime rinore

Në qendrën e FRI-së në Shkup u realizua trajnimi “Orientimi Profesional” për nxënës të vitit të katërt, i udhëhequr nga psikologjia Edlira Destani. Trajnimi synoi njohjen e vetes dhe aftësive për zgjedhje të qëndrueshme akademike e profesionale, ndërsa pjesëmarrësve iu shpërndanë mesazhe motivuese dhe test vetëvlerësimi.



Shkolla verore 2025

Shkolla Verore 2025, me moton “Njih veten, forco shpirtin dhe ndriço rrugën”, zgjati dy ditë në Shkup dhe Kumanovë, duke mbledhur të rinj nga shkollat e mesme dhe studentë në një ambient të pasur me dije, reflektim dhe frymëzim. Temat e ligjëruara në këtë shkollë ishin: “Kush jam unë?”, “Kush jam unë në dritën e Kuranit dhe Sunetit”, “Sabri, namazi dhe dhikri si terapi shpirtërore”, “Ndikimi i rrjeteve sociale në vetëvlerësim”, “Islami dhe modestia në epokën digjitale”, “Kuptimi i jetës dhe lumturia e qëndrueshme”.

Ligjërues të këtyre temave ishin: Edlira Destani, Omer Dauti, Sumeja Peza, Edina Mici Ademi, Hasan Baftijari, Azir Avdiu, Esmâ Sherifi Kurti, Mevlan Abazi, Jusuf Beqiri.

Kjo shkollë verore u përmbyll në ambientet e qendrës rinore të FRI-së me një program përmbledhës që përfshiu certifikata për pjesëmarrësit, video-përmbledhje me momentet kryesore dhe fjalime motivuese.





Trajnimi dy-ditor “Liderët e Rinj”

Në hapësirat e FRI – Shkup, u zhvillua trajnimi dy-ditor “**Liderët e Rinj**”, i cili mbledhi studentë për të zhvilluar aftësitë udhëheqëse dhe fuqizuar rolin e tyre në shoqëri. Ligjëruesit Leonard Kaja, Musa Musai, Edlira Destani, Abil Baush, Hasan Baftijari dhe Medin Bajrami trajtuan tema si komunikimi efektiv, inteligjenca emocionale, motivimi, strategjitë e zhvillimit personal dhe profesional, lidhshipi profetik dhe aftësitë për punë ekipore.

Pjesëmarrësit morën pjesë në aktivitete interaktive dhe workshop praktik duke fituar njohuri teorike dhe praktike për lidhshipin dhe vetëzhvillimin. Trajnimi përfundoi me certifikata për pjesëmarrësit dhe vlerësim të angazhimit të tyre.





**BURSA PËR NXËNËS
DHE STUDENTË**

Bursa për nxënës dhe studentë

Bursat për nxënës të shkollave të mesme dhe studentë universitarë janë një nga format më të rëndësishme të motivimit të të rinjve. Gjatë vitit akademik 2024/25, numri i përfituesve nga këto bursa ishte 145. Përveç bursave mujore, nxënësit dhe studentët kanë përfituar edhe nga takimet mujore që janë realizuar gjatë vitit.



Nxënësit nga Kumanova dhe Shkupi ndoqën ligjëratat në qendrën tonë në Shkup, ata nga Tetova dhe Gostivari i ndoqën në qytetin e Tetovës, ndërsa nxënësit nga Kërçova dhe Prilepi në qytetin e Kërçovës.

Në **takimin e parë**, të realizuar në Shkup me gjithë studentët nga të gjitha qytetet, me temën "Sfidat bashkëkohore në thjerrzën e optimizmit", para studentëve u drejtua Fisnik Shabani, ndërsa tek nxënësit u elaborua tema "Marrëdhëniet shoqërore dhe ndjenja e izolimit tek të rinjtë" nga psikologeja Edina Mici Ademi.

Në **takimin e dytë** u trajtuan temat "Koncepti i Zotit në Islam" dhe "Rëndësia e harmonizimit të traditës me bashkëkohoren". Në Shkup dhe Kërçovë, temën e parë e ligjëroi hoxhë Hasan Baftijari, ndërsa në Tetovë Mevlan Abazi. Temën e dytë në Shkup e shtjelloi Kujtim Kasami dhe në Tetovë Arsim Jonuzi.

Në **takimin e tretë** u trajtuan tema me rëndësi të veçantë. Në Shkup, hoxhë Zija Ismaili ligjëroi mbi temën "Mbrotja e familjes", ndërsa Fuad Jonuzi shtjelloi temën "Rëndësia e respektit të të drejtave të njeriut". Në Tetovë, hoxhë Ismet Tairi prezantoi temën "Kurani si udhëzues në më të mirën", ndërsa Rahim Husejni foli për "Rolin e mediave në formimin e modeleve". Në Kërçovë, Kujtim Kasami diskutoi po ashtu për temën "Roli i mediave në formimin e modeleve".

Në **takimin e katërt** u trajtuan temat "Mbrotja e familjes" dhe "Lutja dhe rëndësia e saj në jetën e njeriut". Në Kërçovë ligjëroi Muhamed Mehmedi, ndërsa në Tetovë Mevlan Abazi mbajti ligjëratën "Lutja dhe rëndësia e saj në jetën e njeriut".





Në **takimin e pestë** u trajtuan temat “Guximi për të qenë ndryshe, të rinjtë dhe identiteti i tyre në Islam” dhe “Të jetosh me kuptim”. Në Shkup dhe Tetovë, ku morën pjesë edhe bursistët nga Gostivari, ligjëruesja Sumeja Peza foli mbi guximin e të rinjve për të ruajtur identitetin islam në shoqërinë moderne. Ndërsa në Kumanovë, Kujtesa Xheladini ligjëroi temën “Të jetosh me kuptim”.

Në **takimin e gjashtë** u trajtuan temat “Islami, nevojë e civilizimit modern” dhe “Ndikimi i singëritetit në formimin e personalitetit të njeriut”. Në Shkup ligjëroi Mr. Xhabir Emini, ndërsa në Tetovë Mevlan Abazi foli mbi rolin e singëritetit në formimin e karakterit dhe personalitetit të njeriut.

Takimi përmbyllës për vitin akademik 2024/25 u mbajt në hapësirat e Komunës së Çairit, duke shënuar mbylljen e një viti të pasur me angazhim dhe përkushtim. Fjalë rasti mbajti kryetari i Forumit Rinor Islam, Abdulhamid Mustafa, ndërsa me një fjalim motivues u paraqit Zuhri Kamberi, i cili i inkurajoi bursistët të vazhdojnë rrugën e dijes dhe përmirësimit shpirtëror. Në fund, u bë ndarja e certifikatave të mirënjohjes për bursistët më të përkushtuar gjatë vitit.





**TRAJNIMET EDUKATIVO-AFTËSUSESE
ME BURSISTËT**



**BURSA PËR NXËNËS DHE STUDENTË
2024/2025**





PLATFORMA
MOZAIKU RINOR

Platforma “Mozaiku Rinor”

“**Mozaiku rinor**” është një aktivitet shumë i rëndësishëm i FRI-së, i cili synon edukimin e të rinjve në fusha të ndryshme, si etika dhe morali, teknologjia, shëndetësia, komunikimi, sociologjia, media dhe fusha të tjera të ngjashme. Përveç aspektit edukativ, veçoria kryesore e “**Mozaikut rinor**” është pasurimi i ligjëratave me lojëra të shumta, me qëllim argëtimin dhe rritjen e vëmendjes së pjesëmarrësve. Ky aktivitet përfshin nën-projektet: **Eureka**, **Incept** dhe **Talentium**.



EUREKA

Ky është një projekt që realizohet me nxënësit e klasave të nënta. Gjatë këtij viti projekti EUREKA u realizua në qytetet e Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës.

Në Shkup, aktiviteti “Mozaiku Rinor” u zhvillua përmes gjashtë takimeve të pasura me tema të ndryshme. Takimi i parë nisi me ligjëratën “Zhvillimi personal dhe vetëvlerësimi” nga Afrim Demiri, pasuar nga pjesa interaktive me lojëra të udhëhequr nga Medin Bajrami. Takimi i dytë u mbajt nga Bujar Muça mbi “Rëndësinë e edukimit dhe motivimin për të ardhmen”. Projekti “Eureka” solli takimin e tretë me temën “Si të ndërtojme një imazh pozitiv për veten?”, të udhëhequr nga Zubejda Murtezi Fazliu. Në takimin e katërt, Zuljeta Fetaj ligjëroi mbi “Metodat e të Mësuarit Efektiv”. Takimi i pestë solli një qasje artistike përmes filmit “King Richard”, ndërsa takimi i gjashtë dhe përfundimtar u mbajt nga Hoxhë Jusuf Beqiri me temën “Modeli i të riut të suksesshëm”, duke sjellë si shembull figurën e Muhammedit a.s.





Në Kumanovë, “Mozaiku Rinor” u realizua përmes një serie takimesh të fokusuar në zhvillimin personal dhe shoqëror. Takimi i parë, i mbajtur nga Bunjamin Selimi, trajtoi temën “TeamBuilding / Gjithëpërfshirje”. Takimi i dytë u udhëhoq nga Arsim Jonuzi mbi “Të jesh i suksesshëm”. Në takimin e tretë, Liridon Ismaili ligjëroi mbi “Vullnetarët e sotëm, liderët e së nesërme”. Takimi i katërt u zhvillua në bashkëpunim me Kryqin e Kuq mbi “Reagimin në emergjencë”. Takimi i pestë solli temën “Rrjetet Sociale” nga Afrim Demiri, ndërsa takimi i gjashtë dhe final u mbajt nga Emine Alimi mbi “Zhvillimin e Karrierës”. Aktiviteti përmbyllës i projektit “Eureka” u shënuar me shpërndarjen e certifikatave dhe reflektimin mbi përvojat e fituara.





Në Tetovë, takimi i parë përfshiu dy tematika: prezantimin e Forumit Rinor Islam si organizatë dhe ligjëratën “Truri dhe procesi i të menduarit” nga Munibe Qamili. Takimi i dytë, i udhëhequr nga Alma Rustemi, trajtoi “Zhvillimin e karrierës”, duke ofruar udhëzime mbi përgatitjen e CV-së dhe prezantimin në intervista. Takimi i tretë solli temën “Në mendjen e adoleshentëve” nga Munibe Qamili, ndërsa takimi i katërt u mbajt nga Lazi Tefiki mbi “Si ndërtohet e ardhmja e një të riu”. Takimi i pestë, në kuadër të projektit “Eureka”, solli një diskutim mbi “Vetëbesimin dhe paragjykimet”, i udhëhequr nga Minibe Qamili. Të rinjtë ndanë mendimet dhe përvojat e tyre personale, duke reflektuar mbi paragjykimet që hasin në shkollë dhe shoqëri, si dhe rëndësinë e vetëbesimit në zhvillimin personal e social. Përmes një qasjeje interaktive, pjesëmarrësit u angazhuan aktivisht në temën e trajtuar, duke nxjerrë hapa konkretë për forcimin e vetëbesimit.



“Mozaiku Rinor” dëshmoi se kur të rinjtë angazhohen në aktivitete të menduara mirë, ata jo vetëm që fitojnë njohuri të reja, por edhe zhvillojnë aftësi jetësore, vetëbesim dhe ndjenjën e përkatësisë. Ky projekt u bë një platformë e fuqishme për edukim, motivim dhe bashkëpunim, duke lënë gjurmë të qëndrueshme në formimin e brezit të ri.

Në gjurmët e më të mirëve



MANIFESTIMI
“NË GJURMËT E MË TË MIRËVE”

Manifestimi “Në gjurmët e më të mirëve”

Manifestimi “Në gjurmët e më të mirëve” mbetet një nga aktivitetet më të rëndësishme që Forumi Rinor Islam organizon. Këtë vit me sukses u realizua hera e njëzet e pestë me radhë.

Forum i Rinor Islam realizoi në Teatrin Kombëtar Maqedonas manifestimin tradicional “Në gjurmët e më të mirëve”, i cili këtë vit mori një dimension të veçantë për shkak të **25-vjetorit** të themelimit të organizatës.

Programi, i moderuar nga Medin Bajrami dhe Zehra Aliu, filloi me lexim të ajeteve kuranore nga kurra Abdurrahim Sulejmani dhe fjalën përshëndetëse të kryetarit Abdulhamid Mustafa.

U dekoruan nxënësit më të dalluar nga shkollat e mesme të gjashtë qyteteve të vendit, ndërsa hafizi më i ri i vitit u shpall 13-vjeçari Ajan Ibrahim nga Batinca e Shkupit.

Programi u pasurua me ilahi nga grupi i kënduesve përbërë nga Nusret Kurtishi, Nderim Alimi, Nafidan Miftari dhe Almin Shaqirin ku interpretuan ilahi të zgjedhura dhe video-monologun “Një histori që frymëzon - 25 vjet FRI”.

U ndanë dekorata për personalitete me kontribut të veçantë: Dr. Kadir Shabani (post mortum), klubi i hendbollit WHC Çair, Doc. Dr. Irfan Ismaili, Dr. Taxhedin efendi Bislimi dhe kompania “Fimar Ballkan”.

Në fund u dekoruan studentët më të dalluar të pesë universiteteve të vendit, ku tre studente arritën mesataren 10.00.

Manifestimi përcolli mesazhin se ky jubile 25-vjeçar shënon vazhdimin e angazhimit të FRI-së për edukim, dije dhe vlera në shërbim të rinisë dhe shoqërisë.



25
yıl
1992-2017
T.C. Cumhurbaşkanlığı
Kültür Varlıkları
Genel Müdürlüğü



Në gjurmët e më të mirëve

25
thi mbledhje e Ejf-it

ERI
EUBANK UNIVERSITY



Në gjurmët e më të mirëve

ERI



**MANIFESTIMI
"NË GJURMËT E MË TË MIRËVE"**


FKI
FORUMI RINOR ISLAM

**FLEKSIBILITET
PËRKUSHTIM
ARRITJE**

**RAMAZANI
SHKËNDIJË E SHPRESËS**

Ramazani shkëndijë e shpresës

Muaji i Ramazanit, muaj i mëshirës, solidaritetit dhe adhurimit, edhe këtë vit ishte një periudhë e veçantë për Forumin Rinor Islam. Nën moton “Ramazani, çelësi i fitoreve”, u realizua një seri aktivitesh të larmishme me përfshirje të gjerë të rinisë, institucioneve dhe komunitetit të gjerë, duke lënë gjurmë në çdo qytet ku shtrihet veprimtaria e FRI-së.



“Mirë se vjen ramazan”

Shpërndarja e hurmave bashkë me planerat e Ramazanit dhe dhikërmatësit u realizua në qytetin e Tetovës nga anëtarët e FRI-së, duke ndarë atmosferën festive me qytetarët. Një shpërndarje e ngjashme me hurma u realizua edhe në qytetin e Kumanovës.

Tribuna “Mirë se erdhe Ramazan” u organizua në ambientet e Teatrit Shqiptar nga Forumi Rinor Islam. Programi përfshiu lexim të ajeteve kuranore, ligjërata nga hoxhë Ardian Sejdiu dhe hoxhë Hasan Baftijari mbi vlerat shpirtërore të Ramazanit, fjalë përshëndetëse nga kryetari i FRI-së Abdulhamid Mustafa, si dhe pjesë artistike me ilahi, monolog dhe shpërndarje hurmash për të pranishmit.

“Shporta e Ramazanit” në Komunën e Likovës dhe Kumanovës u realizua në bashkëpunim me Shoqatën Edukative “Vllaznia”. Në këtë aktivitet, u përgatitën dhe shpërndanë 220 shporta me vlerë 1500 denarë për jetimë dhe familje në nevojë.

Shpërndarja e shportave në Tetovë u realizua në bashkëpunim me O.H. “Kalliri i Mirësisë”. U shpërndanë 200 pako me vlerë 1800 denarë, të mbledhura përmes donacioneve në tentat e vendosura në dy marketet e Ramstor-it në Tetovë.





IFTARE

U realizua **iftari tradicional në Shkup**, nën moton “Ramazani, çelësi i fitoreve”, duke bashkuar anëtarë, aktivistë, donatorë dhe mysafirë nga vendi e Turqia në një atmosferë vëllazërore. Programi përfshiu lexim të ajeteve kuranore, fjalë përshëndetëse nga kryetari i FRI-së, Abdulhamid Mustafa. Në iftar morën fjalën edhe kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, dhe afaristi turk Aziz Bajram. FRI falënderoi të gjithë donatorët për mbështetjen dhe kontributin në këtë ngjarje tradicionale të unitetit dhe solidaritetit.

Iftari tradicional në Tetovë, në bashkëpunim me “Kalliri i Mirësisë”, u mbajt në restaurant “Fontana”. Në këtë iftar morën pjesë nxënës, studentë, profesorë, përfaqësues të institucioneve dhe aktivistë të FRI-së. Me fjalë përshëndetëse u drejtua kryetari i degës Arsim Iseni dhe kryetari në nivel qendror Abdulhamid Mustafa. Gjatë mbrëmjes u shpallën fituesit e konkursit për “Esenë më të mirë të Ramazanit”, ku u ndanë dhurata dhe mirënjohje për pjesëmarrësit.



Iftari tradicional në Kumanovë, në restorantin “Elegant” në Opajë, në bashkëpunim me Komunën e Likovës. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të komunës, drejtues të FRI-së, imamë, familje dëshmorësh, donatorë dhe aktivistë. Programi përfshiu fjalime përshëndetëse, mesazh fetar nga hoxhë Azir Avdiu, si dhe pjesë artistike me ilahi nga Avni Nebiu, duke e mbyllur mbrëmjen në frymën e bashkëpunimit, vëllazërisë dhe respektit të ndërsjellë.





Iftar me aktivistët - dega Kumanovë organizoi një iftar të veçantë me anëtarët dhe aktivistët e saj, në një atmosferë vëllazërore e miqësie. Ky aktivitet tradicional kishte për qëllim forcimin e lidhjeve mes aktivistëve dhe nxitjen e bashkëpunimit, duke përcjellë mesazhin e unitetit, solidaritetit dhe vlerave të vërteta të Ramazanit.

Dega Kërçovë, organizoi **iftar të përbashkët me nxënësit e projekteve** të tyre dhe me nxënësit e Shkollës Edukative “Haxhi Nazim Xhaferri”, i shoqëruar me ligjëratën “Ramazani, muaji i Kur’anit” nga Dr. Kujtim Kasami. Ngjarja u zhvillua në atmosferë uniteti dhe reflektimi shpirtëror.



Aktivitetet edukative dhe garuese

Kuizi islam në Shkup, i cili mblodhi nxënës të klasës së IX nga shkollat fillore. Pjesëmarrësit patën mundësinë të testojnë njohuritë e tyre përmes 100 pyetjeve të në disa etapa garuese.

Kuizi “Ikra” në Prilep, tashmë tradicional i organizuar në xhaminë “Bedër” të fshatit Cërnilishtë, ku të rinjtë testuan njohuritë e tyre në fusha të ndryshme. Fituesit u shpërblyen me libra dhe të holla, ndërsa pjesëmarrësit me lëvdata.





FRI - Dega Kumanovë organizoi aktivitete me nxënësit e shkollave të mesme mbi temën **“Rëndësia e Ramazanit, agjërimi, nxënësit dhe përgjegjësitë e tyre”**, në gjimnazin “Sami Frashëri” dhe SHMTK “Nace Bugjoni”. Takimet synuan të reflektojnë mbi vlerat shpirtërore dhe edukative të Ramazanit, si dhe mbi disiplinën, përkushtimin dhe obligimet e nxënësve ndaj shkollës dhe shoqërisë. Programi përfshiu fjalime nga drejtues të shkollave dhe të FRI-së, si dhe ligjërata nga hoxhë Shaban Neziri.

Punëtori artistike me aktivistët e Forumit Rinor Islam në Shkup, me aktivistët, ku përmes vizatimeve, pikturave dhe formave të tjera artistike u shprehën ndjenjat dhe mesazhet frymëzuese të Ramazanit. Aktiviteti kishte për qëllim promovimin e kreativitetit, bashkëpunimit dhe përjetimit shpirtëror të muajit të bekuar.

Forumi Rinor Islam – Dega Kumanovë dhe Shoqata Edukative “Vllaznia” organizuan **koncertin tradicional të Fitër Bajramit** në qendër të Kumanovës. Aktiviteti përfshiu këndime ilahish dhe tekbiere nga Armend Beqiri, Avni Nebiu, Aldin Murati dhe Jasin Bajrami, si dhe një kuiz simbolik për fëmijët. Atmosfera festive u kompletuar me balona, duke përcur mesazhin e paqes dhe gëzimit të Bajramit.





Ramazani i këtij viti shënoi një rrugëtim të frytshëm dhe të begatë për Forumin Rinor Islam. Nën moton “Ramazani – Çelësi i Fitoreve”, përmes aktiviteteve fetare, edukative, sociale dhe humanitare, u përçuan mesazhe të shpresës, dashurisë dhe solidaritetit. Ashtu si një çelës që hap zemrat dhe rrugën drejt mirësisë, edhe ky Ramazan la pas dritën e tij për të vazhduar me besim dhe vendosmëri drejt fitoreve të reja.

KOKTEJE BAJRAMI

Dega Kumanovë organizoi koktejin e Fitër Bajramit, ku morën pjesë anëtarë të kryesisë, aktivistë dhe përfaqësues të Shoqatës “Vllaznia”. Ngjarja u zhvillua në atmosferë festive e vëllazërore, duke përcjellë mesazhin e unitetit dhe gëzimit të Bajramit.

Gjithashtu dhe FRI – dega Shkup realizoi koktejin e Bajramit me pjesëmarrjen e aktivistëve dhe të rinjve të projekteve të FRI-së.





25-VJETORI
I FORUMIT RINOR ISLAM

25-vjetori i Forumit Rinor Islam



Forumi Rinor Islam organizoi manifestimin jubilar me rastin e 25-vjetorit të themelimit, nën moton **“Një çerek shekulli në shërbim të shoqërisë”**. Ngjarja u zhvillua në një atmosferë festive me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë, organizatave partnere, donatorëve dhe aktivistëve. Kryetari Abdulhamid Mustafa theksoi arritjet dhe sfidat e FRI-së ndër vite, ndërsa të ftuarit patën mundësi të ndjekin video përkujtimore dhe një panel me ish-kryetarët e organizatës, të cilët ndanë përvojat e tyre.

Gjatë aktivitetit u ndanë mirënjohje për komunat partnere dhe ish-kryetarët e FRI-së, si dhe u hap një ekspozitë fotografike që pasqyron veprimtarinë 25-vjeçare të forumit. Manifestimi u përmbyll me një atmosferë miqësore dhe reflektuese mbi rrugëtimin e FRI-së.





**25-VJET FRI
NJË ÇEREC SHEKULLI NË SHËRBIM TË SHOQËRISË**

25 një çerek shekulli
në shërbim të shqiptarëve

emër të përbashkë





**AKTIVITETET
E BRENDSHME**

Aktivitetet e brendshme



Në ambientet e hotelit "New Star", FRI realizoi Kuvendin e XVIII Raportues dhe Zgjedhor. Pas prezantimit të raporteve vjetore nga kryetari në detyrë, Mr. Xhabir Emimi, u zhvilluan zgjedhjet për udhëheqjen e re. Kryetar i FRI-së për mandatin 2025–2029 u zgjodh Abdulhamid Mustafa. Kuvendi u përmbyll me miratimin e kryesisë së re dhe përfundimin e procedurave statutare.

Në kuadër të mandatit të ri drejtues, Kryesia Qendrore e Forumit Rinor Islam (FRI) realizoi dhe miratoi **Planin Strategjik të Organizatës**, i cili përcakton prioritetet dhe drejtimit kryesore të veprimit për periudhën e ardhshme.

Kuvendi Zgjedhor dhe Raportues i FRI – Dega Tetovë u shënua nga prezantimi i raporteve vjetore dhe zgjedhjet e reja, ku kryetar i degës u zgjodh Arsim Iseni, ndërsa Ismet Tairi u zgjodh kryetar i kuvendit.

Në FRI – Dega Kërçovë, pas prezantimit të raporteve për vitin 2023/2024, kryetari Shukri Sadiku u rizgjodh për një mandat të dytë, ndërsa Fazli Asani dhe Besa Mehmedi u zgjodhën kryetar dhe nënkryetare të kuvendit.

Kuvendi Zgjedhor dhe Raportues i FRI – Dega Shkup vlerësoi aktivitetet e realizuara gjatë vitit të kaluar. Kryetari Afrim Demiri prezantoi raportin vjetor dhe financiar, duke fituar sërish besimin e kuvendarëve për një mandat të ri.





SHËTITJE

Shëtitje

Shëtitjet vazhdojnë të jenë disa nga metodat më të mira për t'i motivuar aktivistët dhe anëtarët tonë. Disa nga këto shëtitje të realizuara gjatë vitit 2025 janë:



FRI – dega Kumanovë organizoi një shëtitje me vajzat aktiviste në Kodrën e Diellit, duke kaluar një ditë plot harmoni, reflektim dhe miqësi në frymën e vlerave islame.



Vajzat e FRI – Shkup kaluan një ditë të veçantë në Villen Markova Sushica, duke forcuar shoqërinë, bashkëpunimin dhe vlerat e përbashkëta në një atmosferë të ngrohtë miqësore.

Cjithashtu edhe djemtë aktivistë të FRI – Shkup realizuan një shëtitje një ditore në Villën Markova Sushica, duke shijuar natyrën dhe forcuar lidhjet vëllazërore e shpirtërore.





VIZITA

Vizita



Gjatë kësaj periudhe, Kryetari i FRI-së, z. Abdulhamid Mustafa, së bashku me anëtarë të kryesisë qendrore, realizoi vizita dhe takime në komunat Çair, Saraj, Haraçinë, Studeniçan dhe Tearcë. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit institucional dhe iniciativat konkrete në mbështetje të rinisë. Vizitat shërbyen gjithashtu për thellimin e komunikimit me pushtetin lokal dhe ndërtimin e partneriteteve afatgjata.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, u realizuan edhe vizita urimi në Komunën e Haraçinës dhe Komunën e Studeniçanit, ku u zhvilluan bisedime për projekte të përbashkëta që synojnë fuqizimin dhe aktivizimin e rinjve në nivel lokal.

Po ashtu, përfaqësues të FRI-së zhvilluan vizitë në Komunën e Likovës, ku kryetari i FRI-së – dega Kumanovë, Memedali Limani, së bashku me Samir Mustafën, u pritën nga kryetari i komunës, z. Erkan Arifi. Takimi u fokusua në mundësitë e bashkëpunimit për angazhimin e rinisë dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.






Përveç vizitave institucionale, në ambientet e FRI-së u zhvilluan edhe **takime me përfaqësues të organizatave dhe personaliteteve nga vendi dhe jashtë tij.**

Kryetari i FRI-së priti z. Korab Hajraj, kryetar i organizatës AKEA nga Republika e Kosovës, i cili realizoi vizitë urimi me rastin e zgjedhjes së kryetarit të ri të FRI-së, ndërsa në një takim tjetër FRI mirëpriti hoxhë Ramazan Kayan nga Turqia, me të cilin u shkëmbyen përvoja dhe ide për projekte në fushën edukative dhe shpirtërore.

Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, **FRI mirëpriti edhe përfaqësues të organizatës KAAF nga Bahrejni, ku u diskutuan mundësitë për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në shërbim të rinisë dhe promovimin e vlerave islame.**

Këto vizita dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të FRI-së për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme institucionale dhe për fuqizimin e rolit të rinisë në shoqëri.





MEDIA

Media

Duke e marrë parasysh ndikimin e madh që media ka në botën moderne, FRI i jep një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në media, e sidomos rrjeteve sociale. Ndër aktivitetet tona më të rëndësishme në këtë sferë do të përmendim:



Pjesëmarrja në emisionin e Radio Shkupi - Kryetari i Forumit Rinor Islam, z. Abdulhamid Mustafa, ishte i ftuar në emisionin e Radio Shkupi ku u zhvillua një intervistë me gazetaren Rexhije Bilalli. Gjatë bisedës, u vu theksi te shënimi i 25-vjetorit të themelimit të FRI-së, një moment i rëndësishëm që reflekton një çerek shekulli angazhim dhe kontribut në fuqizimin e të rinjve në vend.

Forumi Rinor Islam ishte i ftuar në emisionin “Ritmi i Ditës” në RTM, ku kryetar i FRI – dega Shkup, Afrim Demiri, prezantoi manifestimin “Në gjurmët e më të mirëve”, edicioni jubilar i 25-të, duke theksuar rëndësinë e tij në promovimin e të rinjve shembullorë.

FRI u nderua me çmimin “Bashkëpunimi më i Mirë” në Kuvendin Zgjedhor të FEMYSO-s (16–19 tetor 2025, Köln), i cili iu dorëzua anëtarit të Kryesisë, Vullnet Selmani.





Buletini vjetor 2024 - Në kuadër të aktiviteteve që Forumi Rinor Islam ndërmerr për të informuar publikun e gjërë mbi aktivitetet që organizon, realizon dhe planifikon, nxori nga shtypi buletin periodik të rradhës.

Në të janë të përfshirë një pjesë e madhe e aktiviteteve që FRI ka realizuar në të gjitha qytetet që graviton, përgjatë periudhës së vitit 2024

Nën moton **“Nga vetja për shoqërinë”**, ZMP bëri ribrendimin e organizatës ku shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të imazhit, transparencës dhe afrimit me publikun.

ZMP ka vazhduar të jetë aktive në rrjetet sociale duke shpërndarë: reels të ndryshëm mbi aktivitetet, përkujtues, salavati ditës xhuma, letra ngushëlluese dhe urime, përkujtuesit gjatë muajit Ramazan, urime për ditë të veçanta kombëtare dhe fetare, komunikata të ndryshme...





25 një çerek shekulli
vjet në shërbim të shogërisë

E: info@fri.org.mk
W: www.fri.org.mk